



## **Australian Government**

### **Department of Health**

#### **VIKTORIA NUK ËSHTË E VETME NË REAGIMIN E FUNDIT NDAJ COVID-19: ZYRTARI KRYESOR MJEKËSOR**

Ne jemi të shqetësuar në lidhje me shpërhtimin e COVID-19 në Viktoria dhe për rastet e transmetimit në komunitet.

Si ushtrues detyre në rolin e Zyrtares Kryesore Mjekësore Kombëtare, dhe si Kryetar i Komitetit Principal për Mbrojtje Shëndetësore të Australisë (AHPPC) duke përfshirë të gjithë Zyrtarët Kryesore Mjekësore të shtetit dhe territorit, në mënyrë adekuate mund të them se Commonwealth mbështet veprimet e ndërmarra nga Qeveria e Viktorias për të ndaluar virusin. Vazhdojmë të takohemi çdo ditë dhe fuqishëm mbështesin atë çfarë po bën Viktoria.

Reagimi i Viktorias – përfshirë qasjen e theksuar të testimit, ndjekjes dhe izolimit, plus distancimi fizik dhe kufizimet në lëvizje – është saktësisht qasja që kemi bërë në nivel kombëtar. Dhe siç edhe e dimë, ajo funksionon. Kjo është arsyeja, në krahasim me cilindo shtet, Australia ka reaguar shumë mirë gjatë pandemisë deri më tani. Në nivel kombëtar, qasja jonë ka qenë të reagojë fuqishëm, herët – dhe kjo është ajo çka po ndodh në situatën e Viktorias.

Shpërthimet sikurse në Viktoria ishin të pritura, edhe pse kemi shpresuar se nuk do të ndodhin. Si një epidemiolog me përvojë 30 vjeçare nëpër botë për një varg të sëmundjeve infektive përfshirë HIV/AIDS, tuberkuloza dhe influenca, e di se kemi të bëjmë me një sëmundje shumë infektive. COVID-19-it i duhet një inkurajim i vogël për t'u përhapur, dhe shumë shpejt të del nga kontrolli, ashtu që duhet të jemi të zgjuar dhe fleksibil në reagimin tonë. Si dhe të jemi plotësisht vigjilent.

Ajo se do të ketë shpërthime herë pas here ka qenë në planin tonë të reagimit për gjatë tërë kohës. Ashtu që e dimë se çfarë duhet bërë. E dimë se ku gjenden shumica e rasteve në Melburn dhe se ku duhet të fokusojmë përpjekjet tona. Tani është duke u zhvilluar një proces i madh testimi. Qëllimi të ndalet shpërthimi sa më shpejt që është e mundur për të ndaluar përhapjen. Këtë e kanë bërë me sukses tasmanianët në North West (Veri Perëndim) të shtetit të tyre. Dhe kjo është pikërisht çfarë po bënë ekipi i Viktorias tani.

Duke zbatuar modelin e Tasmania në një vend urban ka sfida por veprimi i ndërmarrur nga Viktoria është i duhur dhe proporcional. Ai drejtohet sipas



## **Australian Government**

### **Department of Health**

shkencës. Ai bazohet në të dhëna në kohë reale dhe praktikë të mirë të shëndetit publik, dhe do të mbronë dhe shpëton jetë.

Mos të harrojmë shumë gjëra pozitive. Është një fakt i padiskutueshëm se Australia – siç u përmend më parë – ka vepruar shumë mirë ndaj kësaj pandemie, dhe Viktoria është pjesë e këtij suksesi. Duke iu faleminderuar kornizës së qartë strategjike dhe kapacitetit të dhënë nga ekspertët mjekësor dhe liderëve politik në Commonwealth, bashkë me angazhimin dhe përkushtimin e komunitetit të Australisë, kemi arritur të sheshojmë kurbën e koronavirusit në nivel kombëtar. Përmasa e shpërthimit në Viktoria akoma është shumë e vogël kur krahasohet me përmasën e shpërthimeve në botë. Por duhet që, dhe kemi, të veprojmë shpejt për të parandaluar përhapjen e mëtutjeshme.

Tani me rikthimin e kufizimeve, i lus viktorianët të jenë të durueshëm. Gjithashtu të jenë të përgjegjshëm pasi që është në interes të tyre, në interes të shtetit të tyre dhe në interes të kombit. Efektiviteti i kufizimeve varet nga zbatimi i komunitetit të rekomandimeve të shëndetit publik. Ne po mbështetemi tek ju.

Ky shpërthim i fundit nuk është një problem viktorian. Ai është problem kombëtar. Ai është problem i çdonjërit. Është duke u dhënë mbështetje nga Commonwealth dhe nga shtetet dhe territoret e tjera – disa qindra punëtor të personelit klinik dhe personel tjetër janë duke ndihmuar me testimin, në kontaktimin e personave për ndjekje dhe në angazhimin publik. Unë jam shumë i inkurajuar – dhe mund të them se jo edhe aq i befasuar – nga ky reagim kombëtar për ta mposhtur virusin. Me rëndësi është, për derisa kemi bërë shumë punë me komunitetet multikulturore, jemi duke dyfishuar përpjekjet tona për të siguruar se po marrim mesazhet e duhura nga kjo pjesë multikulturore e Melburnit.

Dëshiroj që të gjithë viktorianët të dinë se unë dhe kolegët e mi në AHPPC – ekspertët mjekësor dhe shëndetit kombëtar që kanë udhëhequr me reagimin e Australisë ndaj COVID-19 që nga fillimi, jemi me ju në çdo hap tuajin – siç unë besoj, edhe bashkëkombasit e juaj australianë janë gjithashtu me ju. Në këtë jemi bashkë dhe do ta kalojmë këtë bashkë. Kjo është një përpjekje kombëtare. Ajo gjithmonë ka qenë një përpjekje kombëtare. Mposhtja e virusit do të mbronë viktorianët, dhe do të na mbronë të gjithëve.



**Australian Government**

**Department of Health**

**Profesor Paul Kelly**

**Ushtrues detyre si Zyrtar Kryesor Mjekësor**